



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 12

Tiranë – E enjte, 15 janar 2026

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 844 , datë 30.12.2025

Për miratimin e thirrjes për aplikime, kërkesave, kritereve, procedurave dhe afateve që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e tyre për financime dhe/ose masa mbështetëse, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe të shpërblimit të anëtarëve.....

Faqe

919



VENDIM

Nr. 844 , datë 30.12.2025

**PËR MIRATIMIN E THIRRJES PËR
APLIKIME, KËRKESAVE, KRITEREVE,
PROCEDURAVE DHE AFATEVE QË
DUHET TË PLOTËSOJNË *STARTUP*-ET
DHE LEHTËSUESIT E TYRE PËR
FINANCIME DHE/OSE MASA
MBËSHKETËSE, SI DHE TË
RREGULLAVE PËR PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE
ANKIMIT, KRITEREVE, PROCEDURËS
SË PËRZGJEDHJES DHE TË
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 14, të ligjit nr.25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve dhe inovacionit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i:

a) kërkesave dhe i kriterëve që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, procedurave dhe afateve të thirrjes për përfitimin e:

i. instrumenteve financiare që janë masat e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit ose burime të tjera të ligjshme, që nuk janë investime publike, me qëllim arritjen e objektivave të politikave shtetërore, që përfshin por nuk kufizohet vetëm në grante, financime nëpërmjet kapitalit, mbulimin e kostove të pranueshme të përcaktuara për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, si dhe mekanizmat e lehtësimit të rrezikut;

ii. masave mbështetëse që janë instrumentet teknike që lehtësojnë proceset e inovacionit dhe synojnë të forcojnë kapacitetet dhe njohuritë përkatëse të *startup*-eve, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në ofrimin e aksesit në infrastrukturat e kërkimit dhe testimit, shërbimeve të konsulencës ligjore, financiare apo të biznesit, transferimit të teknologjisë dhe vënies në dispozicion të infrastrukturës teknologjike.

b) rregullave për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe të ankimit, kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve.

2. Agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit (në vijim Agjencia) harton dhe i propozon ministrit përgjegjës për inovacionin shpalljen e “Thirrjes për kërkesa për financim dhe/ose masa mbështetëse”, të shoqëruar me vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

3. Agjencia harton dhe publikon në faqen e saj të internetit:

a) thirrjen publike për paraqitjen e kërkesave për financim dhe/ose masa mbështetëse, duke specifikuar llojin e financimit që ofrohet, qoftë instrument financiar i llojit grant, financim me kapital, subvencion, mbulim kostosh apo mekanizma të lehtësimit të rrezikut dhe/ose llojin e masës mbështetëse;

b) fondin në dispozicion për çdo thirrje, të ndarë sipas llojit të financimit dhe/ose masave mbështetëse;

c) dokumentacionin e nevojshëm për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave, përfshirë kërkesat e veçanta për financimin dhe/ose masën mbështetëse;

ç) formularët e aplikimit, të përditësuar sipas llojit të financimit dhe/ose masës mbështetëse të ofruar;

d) kontratën tip, të përshtatur sipas llojit të financimit, si instrument financiar i llojit grant, financim me kapital, subvencion, mbulim kostosh apo mekanizma të lehtësimit të rrezikut dhe të masës/masave mbështetëse;

dh) udhëzimet e detajuara, të cilat përmbajnë informacion për:

i. mënyrën e disbursimit/shpërndarjes së fondeve dhe zbatimin e projektit për secilin lloj financimi dhe/ose masë mbështetëse;

ii. procedurën që zbatohet;

iii. kriteret minimale të kualifikimit dhe dokumentacionin që provon plotësimin e tyre;

iv. kushtet e financimit dhe/ose masën mbështetëse;

v. afatet kohore dhe formalitetet që duhet të respektohen;

vi. kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve;

vii. ndarjen e zërave financiarë sipas llojit të financimit dhe/ose masës mbështetëse dhe sipas projektit;

viii. mënyrën e vlerësimit të kërkesave;



ix. detyrimet e raportimit, sipas llojit të financimit dhe/ose masës mbështetëse;

x. mënyrën e kryerjes së monitorimit të projekteve e të financimit dhe/ose masave mbështetëse.

e) ndryshimet dhe sqarimet e kryera gjatë procedurës së thirrjes;

ë) listën e projektpropozimeve dhe të kandidatëve pjesëmarrës, të ndarë sipas llojit të financimit dhe/ose masave mbështetëse;

f) vlerësimet përfundimtare të projektpropozimeve, të kryera nga komisioni i vlerësimit dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për inovacionin.

4. Agjencia njofton kandidatin pjesëmarrës në procedurat konkurruese për:

a) përzgjedhjen e kërkesës për financim dhe/ose masë mbështetëse;

b) përzgjedhjen e kushtëzuar të kërkesës për financim dhe/ose masë mbështetëse dhe kërkesës për rishikim të tij, bazuar në rekomandimet e komisionit;

c) mospërzgjedhjen e kërkesës për financim dhe/ose masë mbështetëse, pikëzimin e projektpropozimit dhe të drejtën për ankim.

5. Agjencia kryen procedurën e përcaktimit të kushteve kontraktore me kandidatin e përzgjedhur dhe nënshkruan kontratën përkatëse.

6. Agjencia monitoron zbatimin e projekteve të mbështetura dhe përgatit vlerësimin e performancës së financimit dhe/ose masë mbështetëse deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas përfundimit të zbatimit të projektit.

7. Menaxhimi dhe monitorimi i realizimit të “Thirrjes për kërkesa për financim dhe/ose masa mbështetëse” kryhet nga Agjencia në bazë të rregullores “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për financim dhe/ose masa mbështetëse”, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për inovacionin e të publikuar në faqen zyrtare në internet të Agjencisë dhe të ministrit përgjegjës për inovacionin.

II. KËRKESAT DHE KRITERET PËR PËRFITIMIN E FINANCIMIT DHE/OSE MASAVE MBËSHTETËSE

1. Mbështetjen në formën e financimit dhe/ose masave mbështetëse e përfitojnë *startup*-et, *scaleup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik të *startup*-eve dhe lehtësuesve e të pajisur me pasaportën përkatëse, sipas llojit të

financimit dhe/ose masës mbështetëse, të përcaktuar në thirrjen publike.

2. Për qëllime të përfitimit të mbështetjes, sipas kësaj thirrjeje publike, *startup*-et kategorizohen sipas fazave, si më poshtë vijon:

2.1. *Startup*-et në fazën fillestare, të hershme (F1), mund të jenë individë privatë, vendas ose të huaj, përfshirë nomadin digjital, të cilët kanë plan të vijnë operacionet e biznesit në Republikën e Shqipërisë.

2.2. *Startup*-et në fazën e validimit (F2) dhe ato në fazën e rritjes (F3), përfshirë *scaleup*-et, duhet të jenë biznes i regjistruar ligjërisht në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe jo më të vjetër se 6 (gjashtë) vjet në kohën e paraqitjes së kërkesës.

3. Subjekti kërkuar aplikon nëpërmjet platformës digjitale si individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përfshirë nomadin digjital.

4. Çdo subjekt kërkuar ka të drejtë të paraqesë vetëm një aplikim brenda së njëjtës thirrje publike.

5. Mbështeten me financim dhe/ose masa mbështetëse *startup*-et që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) *Startup*-et që përzgjedhin fazën aktuale të zhvillimit të specifikuar nëpërmjet formave të aplikimit:

i. faza fillestare (F1);

ii. faza e validimit (F2);

iii. faza e rritjes (F3).

b) Të kenë përmbushur shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e kërkesës.

6. Mbështeten me financim dhe/ose masa mbështetëse lehtësuesit e *startup*-eve, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Janë persona fizikë ose juridikë, të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, ose në gjykatë, në rastin e OJF-ve;

b) Janë në pronësi të shtetasve shqiptarë;

c) Kanë kryer aktivitete në ndihmë të *startup*-eve gjatë 2 (dy) viteve të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të vërtetuara nëpërmjet kontratave dhe raporteve të publikuara;

ç) Kanë përmbushur detyrimet tatimore në momentin e paraqitjes së kërkesës.

7. Projektet e shpallura fituese zbatohen brenda afatit kohor, të përcaktuar në thirrjen publike për financim dhe/ose masë mbështetëse, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse, ndërmjet përfituesit dhe Agjencisë.



8. Mënyra e disbursimit të financimit, numri i kësteve ose format e tjera të rimbursimit, dokumentacioni justifikues dhe afatet përkatëse përcaktohen në rregulloren “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për financim dhe/ose masa mbështetëse”, që hartohet në varësi të llojit të financimit, qoftë grant, financim me kapital, subvencion, mbulim kostosh apo mekanizma të lehtësimit të rrezikut dhe natyrës së projektit. Disbursimi i financimit realizohet me këste ose në forma të tjera rimbursimi, të lidhura me realizimin e treguesve kyç të performancës së projektit, sipas kushteve të përcaktuara në thirrjen publike dhe në kontratën përkatëse. Për projektet që përfitojnë masa mbështetëse, ofrimi i tyre kryhet sipas kushteve të përcaktuara në thirrjen publike dhe në kontratë.

III. PROCEDURAT DHE AFATET E THIRRJES

1. Në shpalljen e thirrjes evidentohen edhe lloji dhe masa e financimit dhe/ose masave mbështetëse, që parashikohen të akordohen, kërkesat përkatëse sipas llojit, përfshirë dhe afatet përkatëse, në përputhje me pikën 3, të këtij kreu.

2. Kërkesa për financim dhe/ose masë mbështetëse kryhet nëpërmjet platformës digjitale, në portalin “e-Albania”.

3. Afati për dërgimin e kërkesave për financim dhe/ose masë mbështetëse dhe periudha e thirrjes nuk mund të jetë më pak se 10 (dhjetë) ditë punë dhe jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë punë.

4. Dokumentacioni i nevojshëm, që duhet të shoqërojë kërkesën për financim dhe/ose masë mbështetëse, përcaktohet në rregulloren e shpallur të thirrjes.

IV. NGRITJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE ANKIMIT

1. Komisioni i Vlerësimit dhe Komisioni i Ankimit, duke caktuar edhe kryetarët përkatës, ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për inovacionin sa herë që shpallet një thirrje për financim dhe/ose masë mbështetëse. Komisionet funksionojnë deri në përfundimin e detyrës së tyre, por jo më vonë se data e miratimit të listës së përfituesve nga ministri përgjegjës për inovacionin.

2. Komisioni i Vlerësimit ka për qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave nga *startup*-et e lehtësuesit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës

shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i *startup*-eve.

3. Drejtori i Agjencisë është anëtar i Komisionit të Vlerësimit për shkak të detyrës.

4. Komisioni i Ankimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i *startup*-eve.

5. Anëtarët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

5.1. Anëtari i Komisionit, i përzgjedhur nga organet e administratës shtetërore, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë nëpunës i administratës shtetërore;

b) Të ketë pjesë të detyrave të tij funksionale hartimin, zbatimin ose monitorimin e politikave, programeve dhe projekteve për ekosistemin dhe *startup*-et.

5.2. Anëtari i Komisionit, i përzgjedhur nga bota akademike, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë punë përkatëse në universitete dhe/ose organizata kërkimore për fusha specifike, ku përfshin kërkimin dhe zhvillimin për industrinë;

b) Të ketë përvojë menaxhimi brenda sektorit të industrisë ose përvojë në projekte kërkimore;

c) Të ketë përvojë në vlerësimin e projektpropozimeve, në kuadër të programeve kombëtare ose ndërkombëtare në përgjithësi dhe brenda fushave që u përgjigjen objektivave të thirrjes.

5.3. Anëtari i Komisionit, i përzgjedhur nga ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i *startup*-eve, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë punë përkatëse në organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që kanë për qëllim mbështetjen ndaj *startup*-eve dhe lehtësuesve të ekosistemit;

b) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në menaxhimin e projekteve;

c) Të ketë përvojë në bashkëpunim ndër-kombëtar në zhvillim të *startup*-eve dhe të ekosistemit;

ç) Të ketë përvojë si anëtar/kryetar i panelit të ekspertëve ose drejtor i propozimeve të programeve ose projekteve dhe anëtar/kryetar i komisionit të vlerësimit të fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare;



d) Deklarimi i plotësimeve të kriterëve është përgjegjësi personale e çdo anëtarit të komisionit të vlerësimit dhe ankimit.

6. Anëtarët përzgjidhen mbi bazën e një procesi transparent, bazuar në thirrjen e hapur, të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë dhe të ministrit përgjegjës për inovacionin.

7. Agjencia ngarkohet të hartojë thirrjen e hapur, ku listohen kriteret dhe përcaktohen metodologjia e përzgjedhjes, afati dhe mënyra e aplikimit, të menaxhojë procesin e përzgjedhjes së anëtarëve dhe t'ia propozojë për miratim ministrit përgjegjës për inovacionin.

8. Në përfundim të procesit të konkurrimit, ministri përgjegjës për inovacionin shpall fitues, në cilësinë e anëtarit të komisioneve, kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta, si dhe kandidatët e renditur në vijim, në cilësinë e zëvendësuesit, në rast të krijimit të vakancës.

9. Për çdo rast, përpara fillimit të ushtrimit të funksioneve të tyre në lidhje me shqyrtimin, vlerësimin dhe/ose ankimin e kërkesave për financim dhe/ose masa mbështetëse, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe të Komisionit të Ankimit janë të detyruar të plotësojnë e të nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksioneve publike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e aneksit të thirrjes.

10. Anëtarit i Komisionit, i cili gjendet ose deklaron se gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, aktual ose potencial, nuk merr pjesë në shqyrtimin, vlerësimin, vendimmarrjen dhe/ose ankimin e kërkesës përkatëse dhe zëvendësohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim.

11. Rregullimi, parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konfliktit të interesit për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe të Komisionit të Ankimit kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

12. Anëtarit i Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit lirohet nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për inovacionin, në rast se verifikohet njëri prej rasteve të mëposhtme:

a) Ka ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionin ose me organizatën kërkimore që përfaqëson;

b) Është dënuar me vendim penal të formës së prerë;

c) Bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;

ç) Me veprimet e tij dëmton veprimtarinë e komisionit dhe imazhin e institucionit përgjegjës për funksionimin e këtij komisioni;

d) Nuk merr pjesë në 2 (dy) mbledhje radhazi të komisionit pa shkak të arsyeshem dhe nuk ka njoftuar paraprakisht kryetarin;

dh) Nuk deklaron konfliktin e interesit, aktual ose potencial, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

e) Kur paraqet dorëheqjen.

V. VLERËSIMI I KËRKESAVE PËR FINANCIM DHE/OSE MASA MBËSHTE-TËSE

1. Komisioni i Vlerësimit mbledhet në mbledhjen e parë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë punë pas mbylljes së thirrjes për aplikime nga *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve.

2. Sekretariati teknik pranë Agjencisë administron kërkesat së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe i vendos në dispozicion anëtarëve praktikant dokumentare e raportin përmbledhës të aplikimeve.

3. Mbledhjet e Komisionit të Vlerësimit thirren dhe drejtohen nga kryetari i këtij Komisioni.

4. Komisioni i Vlerësimit merr në shqyrtim kërkesat për financim dhe/ose masë mbështetëse dhe në fund të procesit të vlerësimit, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve pune miraton me vendim listën paraprake të aplikimeve fituese.

5. Komisioni i Vlerësimit ushtron këto detyra dhe kompetenca:

a) Shqyrton e vlerëson çdo kërkesë;

b) Plotëson formularët e vlerësimit për çdo kërkesë të dorëzuar dhe anëtarët e tij japin pikët individuale;

c) Përgatit renditjen paraprake të kërkesave, bazuar në pikëzimin dhe vendimmarrjen e të gjithë anëtarëve dhe, sipas rastit, përgatit rekomandimet për rishikim të kërkesave, me qëllim përmirësimin e tyre;

ç) Harton dhe nënshkruan procesverbalin e vlerësimit dhe listën e kërkesave të përzgjedhura për financim dhe/ose masë mbështetëse.

6. Kërkuesit mund të depozitojnë ankesat për shkelje të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për



masë mbështetëse, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi elektronik.

7. Komisioni i Ankimit ka për qëllim shqyrtimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike të ankesave për shkelje të procedurës së shqyrtimit, sipas këtij vendimi nga Komisioni i Vlerësimit.

8. Komisioni i Ankimit mbledhet në mbledhjen e parë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë punë pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu.

9. Sekretariati teknik i ngritur nga Agjencia i vendos në dispozicion anëtarëve të Komisionit të Ankimit praktikant dokumentare të ankimeve të mbërritura dhe raportin pasqyruar të praktikave dokumentare të depozituara.

10. Mbledhjet e Komisionit të Ankimit thirren dhe drejtohen nga kryetari i këtij komisioni.

11. Për organizimin e mbledhjeve të Komisionit të Ankimit njoftohen anëtarët, jo më pak se 2 (dy) ditë punë nga organizimi, dhe mbledhjet janë të vlefshme nëse marrin pjesë të paktën 2 (dy) anëtarë.

12. Në fund të vlerësimit të ankesave, Komisioni i Ankimit miraton me vendim kërkesat për t'ia kaluar për rishqyrtim Komisionit të Vlerësimit, ku parashtron edhe shkeljet procedurale në shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Komisioni i Vlerësimit.

13. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e vendimit nga Komisioni i Ankimit, Komisioni i Vlerësimit merr në shqyrtim të dytë aplikimet e atyre kërkuarëve, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Ankimit.

14. Pas shqyrtimit të dytë të aplikimeve, Komisioni i Vlerësimit merr vendimin për listën përfundimtare të fituesve, i cili i përcillet për miratim ministrit përgjegjës për inovacionin. Urdhri i miratimit publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë, të ministrit përgjegjës për inovacionin, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

15. Agjencia dhe subjekti përfitues nënshkruajnë kontratën për financim dhe masa mbështetëse, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga miratimi i listës së përfituesve nga ministri përgjegjës për inovacionin.

16. Në kontratën për financim dhe/ose masë mbështetëse përcaktohen rregullat, afatet e përgjegjësitë e palëve për realizimin e projektit, dokumentacioni dhe afatet për raportimin përshkrues e financiar, mënyra e disbursimit dhe transferimit të fondeve apo mundësimi i masës

mbështetëse, shpenzimet e njohura e të pranueshme, mekanizmat e raportimit e të kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve të kryera dhe të produkteve e aktiviteteve të realizuara.

17. Agjencia kryen lëvrin e fondit ose mundësimin e masës mbështetëse, sipas parashikimeve të kontratës së nënshkruar me fituesit.

VI. KRITERET VLERËSUESE

1. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, ku secili nga anëtarët i vlerëson ato mbi bazën e pikëzimeve të caktuara në formularët e pikëzimit, të miratuar në rregulloren “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për financim dhe/ose masë mbështetëse”, të miratuar me urdhr të ministrit përgjegjës për inovacionin dhe publikuar në platformën digjitale.

2. Fituesit shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura në raport me fondin total në dispozicion.

VII. MASA E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONEVE

1. Shpërblimi i kryetarëve dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe të Komisionit të Ankimit është në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit.

2. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarëve e të anëtarëve vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje dhe mbulohen nga buxheti i miratuar i Agjencisë.

VIII. RAPORTIMI, MONITORIMI, KONTROLLI DHE VLERËSIMI

1. Raportimi i subjektit përfitues pranë Agjencisë për ecurinë e zbatimit të financimit dhe/ose masës mbështetëse rregullohet nga kontrata përkatëse dhe nga rregullorja “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për financim dhe/ose masa mbështetëse”, pjesë përbërëse e së cilës janë udhëzuesi për raportimin periodik të progresit dhe dokumentet mbështetëse të raportimit.

2. Agjencia kryen kontrolle për zbatimin e financimit dhe masave mbështetëse përmes vizitave në terren dhe verifikimeve dokumentare, si gjatë periudhës së zbatimit, ashtu edhe për një periudhë monitorimi deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas disbursimit të plotë të financimit apo masës



mbështetëse, sipas rastit. Kontrollat realizohen bazuar në:

a) metodologjinë e përzgjedhjes, bazuar në risk dhe në vlerën e financimit ose masës mbështetëse; dhe

b) rregulloren “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për financim dhe/ose masa mbështetëse”.

Metodologjia dhe rregullorja hartohen nga Agjencia dhe miratohen nga ministri përgjegjës për inovacionin.

3. Agjencia kryen çdo vit vlerësimin e performancës së fondit të akorduar nëpërmjet financimit dhe/ose masës mbështetëse, që përfshin vlerësimin e menaxhimit të thirrjes nga Agjencia, si dhe rezultatet e ndikimit të arritur nga kërkesat e financuara. Vlerësimi kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i zbatimit të kërkesave të mbështetura në një program vjetor financimi dhe përmban, të paktën, elementet e mëposhtme:

a) Informacionin për thirrjet publike të zbatuara, sasinë e fondeve të shpërndara dhe shpenzimet e realizuara;

b) Informacionin për numrin e aplikimeve të thirrjes dhe përshkrimin e cilësive dhe të të metave të kërkesave të kandidatëve;

c) Informacionin për arritjet e ndikimit të projekteve të mbështetura dhe kontributin e tyre për realizimin e objektivave të shpallur të thirrjes publike;

ç) Të dhëna për numrin e ankimeve administrative të paraqitura dhe për vendimet përfundimtare të shqyrtimit të tyre.

4. Bazuar në vlerësimin vjetor, Agjencia përcakton masat mbështetëse, nivelin e financimit dhe, sipas rastit, llojet e financimit dhe/ose masës mbështetëse që do të aplikohen në programin pasardhës, si dhe numrin (dhe kalendarin orientues) e thirrjeve publike, që do të zhvillohen në vitin vijues.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Funksionimi i Komisionit të Vlerësimit dhe i Komisionit të Ankimit i nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim dhe në urdhrin për ngritjen e tyre nga ministri përgjegjës për inovacionin.

2. Vendimi nr.61, datë 7.2.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave e të kritereve

që duhet të plotësojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblymit të anëtarëve të tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për inovacionin dhe agjencia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.97/2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, të ndryshuar”, në datën 22.1.2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 48 lekë